




Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut

Opština Kaçanik

Municipality of Kaçanik

01Nr. 109/01-11319/18

Në bazë të nenit 13.3 të Ligjit Nr.05/L125 Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, nenit 4 paragrafi 4.1 dhe 4.2, nenit 7 në harmoni të plot me nenin 8 pika 5, 7, 9 dhe nenit 19 të rregullores Nr.16/2016 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për mbështetje të fermerëve, Kryetari i Komunës me rekomandimin e komisionit për vlerësim të kërkesave nxjerr këtë:

VENDIM

Për mbështetje të bletarëve me mjete financiare për koshere bletësh

I

Me këtë Vendim lejohet ndarja e mjeteve në shumë prej 13,000.00€, për bletarët përfitues të projektit, blerje të koshereve për bletë, me qëllim të realizimit të projektit “Mbështetje të bletarëve me koshere bletësh, e paraparë me buxhetin e vitit 2018.

II

Shuma e mjeteve e paraparë për fermerët përfitues do të transferohet secilit fermerë në llogarinë rrjedhëse bankare, në bazë të marrëveshjes individuale, ofrimit të dëshmisë së fermerit (faturën e blerjes) dhe verifikimit nga komisioni komunal për posedimin- blerjen e koshereve për bletë.

III

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik (të fermerëve).
2. Mbështetja financiare publike për projektet /programet e drejtorisë do të ofrohet nga Buxheti i Komunës, kodi ekonomik 22200 në kuadër të programit subvencione dhe transfere me buxhetin e ndarë për vitin 2018

IV.

1. Mjetet e përmendura në nenin I do të shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

V.

2. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është: Drejtoria e Financave, Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë

VI.

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit

Kryetari i Komunës

Besim Ilazi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

01-104/02-11075/18
Kaçanik.06.04.2018



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 neni 13, Statutit të Komunës së Kaçanikut neni 73 pika 1 dhe pika 3, Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veqanta të Banimit – Gazeta Zyrtare Nr.67/29 mars 2010, shkresës së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dt.05.03.2018 Nr.1597/17, Kryetari i Komunës merr këtë :

VENDIM

PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PROGRAMEVE TRE VJEQARE TË BANIMIT

1. Formohet Grupi Punues për hartimin e programeve tre vjeqare të banimit për Komunën e Kaçanikut.
2. Grupi Formohet në përbërje prej 5 anëtarësh dhe atë :


2.1 Nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale	Xhelal Gashi
2.2 Nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Arsim Zenuni
2.3 Nga Drejtoria e DUKMM-së	Bujar Dullovi
2.4 Zyra për kthim dhe komunitete	Fadil Guri
2.5 Udhëheqës për drejtat e njeriut	Vedat Dema
3. Grupi punues ka për detyrë që deri në fillim të Dhjetorit ta bëjë hartimin e programit tre vjeqar dhe ta procesoj në Kuvend për miratim.
4. Shpenzimet Administrative të krijuara lidhur me punën e këtij grupi punues do të i bartë Kryetari i Komunës
5. Ky grup do të pushoj së vepruari me Hartimin e Programit tre vjeqar të Banimit konform Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veqanta të Banimit .
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës .
7. Me këtë Vendim njoftohen : Anëtarët e Bordit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Arkivi i Komunës .



Kryetari i Komunës
Besim Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opstina Kaçanik
Municipality of Kaçanik

ZYRA E KRYETARIT

01-Nr.104/02-10726/18
Data: 06.04.2018

Në bazë të nenit 13 pika 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, të Rregullores nr. 20/2012 për Punën Vullnetare të Nëpunësve Civil të miratuar në mbledhjen e 93 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër të vendimit 05/93 me datë 04.10.2012, si dhe kërkesës me datë 04.04.2018 nga Fadil Krasniqi, Kryetari i Komunës së Kaçanikut merr këtë:

VENDIM

PËR VAZHDIMIN E PUNËS NË MËNYRË VULLNETARE

1. Z. Fadil Krasniqi në bazë të kërkesës së tij për punë vullnetare iu lejohej të ushtroj detyrën e drejtorit të SHFMU "Qamil Ilazi" në Kaçanik i Vjetër, Kaçanik.
2. Puna vullnetare vazhdon deri në përzgjedhjen e drejtorit të ri.
3. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

I lartpërmenduri ka shfaqur interesimin që vullnetarisht ta vazhdoj ushtrimin e detyrës së drejtorit të shkollës deri në përzgjedhjen e drejtorit të ri. Nga angazhimi i tij ndër vite dhe suksesit të treguar në punë, shfaqim bindjen e plotë që ky vendim do t'i kontribuoj ecures së mirë të procesit të mësimdhënies në këtë shkollë.

Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me vendimin ka të drejtë të parashtroj kërkesë për rishqyrtim të vendimit, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

Vendimi i dërgohet

1. Fadil Krasniqi,
2. Zyrës së personelit,
3. Drejtorisë së DAK,
4. Arkivit.

Kryetari i Komunës
Z. Besim Ilazi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Kaçanikut Opština Kaçanik Municipality of Kaçanik

KRYETARI I KOMUNËS
01-10402-11957/18
Kaçanik, 13.04.2018

Duke u bazuar në nenin 13 të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.- 03/L- 040, neni 73 pika 1 të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008, Kryetari Komunës merr këtë:

V E N D I M
Mbi formimin e komisionit

I
Formohet komisioni për hapjen e ofertave të tenderit "Dhënia në menaxhim të vend gjuetisë së përbashkët të emëruar " Lybeteni " në këtë përbërje:

1. Muhamet Qallaku-kryesues
2. Zekirjah Koxha-anëtar
3. Fadil Guri-anëtar

II
Detyrë e komisionit është që të bëj hapjen e ofertave të tenderit "Dhënia në menaxhim të vend gjuetisë së përbashkët të emëruar " Lybeteni " , dhe të bëj leximin e çmimeve të ofertës.


III
Ky aktvendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

Të njoftohen:
Anëtarët e komisionit
Arkiva e Komunës

Kryetari i Komunës

Besim Ilazi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Kaçanikut Opština Kaçanik Municipality of Kaçanik

KRYETARI I KOMUNËS

01- 370/01- 12197 /K
Kaçanik, 16.04.2018

Duke u bazuar në nenin 13 të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.- 03/L- 040, neni 73 pika1 të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008, Kryetari Komunës merr këtë:

V E N D I M

Mbi formimin e komisionit

I

Formohet komisioni për vlerësimin e ofertave të tenderit "Dhënia në menaxhim të vend gjuetisë së përbashkët " Lybeteni ", në këtë përbërje:

1. Agim Luzha, Zyrtar për mbrojtje dhe kultivim të pyjeve
2. Mustafë Loku, Zyrtar për Bujqësi
3. Zylfi Koxha, Koordinator i sektorit të bujqësisë

II

Detyrë e komisionit është që të bëj vlerësimin e ofertave të tenderit "Dhënia në menaxhim të vend gjuetisë së përbashkët " Lybeteni " dhe të bëj procesverbal, lidhur me dokumentacionin e kërkuar sipas ofertës publike.

III

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

Të njoftohen:
Anëtarët e komisionit
Arkiva e Komunës



Kryetari i Komunës

Besim Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

KRYETARI I KOMUNËS
01 *104/02-12798* /2018
Kaçanik.20.04.2018

Në bazë të nenit 13 të Ligjit të vetëqeverisjes lokale Nr.L-040, Statutit të Komunës të datës 25.09.2008 si dhe Shkresës së Ministrisë së Mjedisit dhe planifikimit Hapësinor Nr.M-01-1354/18 Kryetari i Komunës merr Këtë :

V E N D I M

I

Që Bujar Dullovi Inspektor mjedisor në kuadër të komunës së Kaçanikut caktohet si pikë kontaktuese në mes Komunës së Kaçanikut dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

II

z. Bujar Dullovi gjatë kësaj periudhe do të jep shënime sa me të sakta rreth punës së grupit punues për hartimin e Planit tre vjeçar të banimit.

III

Ky vendim hynë në fuqi ditën e marrjes.

Me këtë vendim njoftohen: Zyra e Kryetarit,
DSHMS dhe
Zyrtari Bujar Dullovi



Kryetari i Komunës Kaçanik
z. Besim Ilazi